VENDIM
Nr. 104, datë 1.10.2013

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "GEN - I TIRANA" SHPK ME NR. 73, SERIA FK08, NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 129, DATË 2.12.2008

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45 pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "f", 5 pika 1 germa "f", 12, 13, 14 pika 1 dhe nenit 16 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "GEN - I Tirana" sh.p.k., për rinovimin e licencës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Gen - I Tirana" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/9, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë "Gen - I Tirana" sh.p.k. me nr. 73, seria FK08, për kryerjen e aktivitetit të furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 129, datë 2.12.2008, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo